



Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

THIRRJE PËR APLIKIM PËR PËRZGJEDHJEN E TË RINJVE (GRUPMOSHA 15-29 VJEÇ) DHE GRA TË PAPUNA PËR MBËSHTETJE NË FILLIMIN E BIZNESIT TË TYRE NË ZONËN E BASHKISË SHKODËR, BASHKIA VAU I DEJËS DHE BASHKIA MALËSI E MADHE.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në kuadër të zbatimit të projektit “Aftësi për Punësim të Qendrushëm dhe Rritje Ekonomike Gjithëpërfshirëse të Rajonit Ndërkufitar të Shqipërisë dhe Malit të Zi – Aftësi për Punësim Shqipëri – Mal i Zi”, “Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mal i Zi – Shqipëri 2014 – 2020”, nën Instrumentin Për Asistencën e Para-Aderimit (IPA II), financuar nga Bashkimi Evropian, shpall thirrjen për mbështetje në fillimin e biznesit të tyre për të rinjtë (mosha 15-29 vjeç) dhe gra të papuna në Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe.

A. THIRRJA KA NË FOKUS MBËSHTETJEN PËR:

1. Trajnim për aftësitë sipërmarrëse për 15 pjesëmarrës;
 2. Mbështetje mentoruese në zhvillimin e planeve të biznesit për 15 pjesëmarrës;
 3. Grant në shumën 3000 euro për pjesëmarrës, për 5 planet e biznesit më të vlerësuara për fillimin e biznesit të tyre.
1. Pjesëmarrje në trajnime për zhvillimin e aftësive sipërmarrëse, për 15 pjesëmarrës të rinj (mosha 15-29 vjeç) dhe gra të papuna në Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe. Trajnimet do të jenë 2 (dy) ditore dhe përfshijnë fushat e mëposhtme:
- Aspekte ligjore dhe regjistrimi i biznesit
 - Menaxhimi financiar dhe kontabiliteti
 - Planifikimi strategjik dhe krijimi i modelit të biznesit
 - Marketingu dhe shitjet
 - Marketing dixhital/ përmbytje
2. Mentorim në zhvillimin e planeve të biznesit për 15 pjesëmarrës të rinj (mosha 15-29 vjeç) dhe gra të papuna në Bashkitë Shkodër, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe. Qëllimi i mbështetjes mentoruese është që pjesëmarrësit të zhvillojnë plane biznesi cilësore pas trajnimit dhe të fitojnë njohuritë e nevojshme për të filluar biznesin e tyre.



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Mentorimi do të ofrohet nga mentorë, ekspertë me një nivel njohurish cilësore, por edhe me përvojë të dëshmuar sipërmarrëse, të cilët do të ofrojnë mbështetje për pjesëmarrësit për 20 orë gjatë trajnimeve individuale.

3. Grant në shumën 3000 euro për pjesëmarrësit e perzgjedhur si fitues: Nga 15 pjesëmarrës gjithsej, do të përfitojnë grant vetëm 5 (pesë) prej tyre, planet e biznesit të të cilëve do të vlerësohen nga një komision i pavarur.

Granti nënkupton mbështetje financiare të pakthyeshme në shumën prej 3000 euro për secilin nga 5 pjesëmarrësit, planet e biznesit të të cilëve janë më të vlerësuarat për fillimin e një biznesi, shumë kjo e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të regjistrimit të biznesit, blerjes së pajisjeve të nevojshme dhe/ose shërbimeve konsulente.

Afati për fillimin e trajnimit me aplikantët e perzgjedhur, do të jetë muaji mars 2024, të cilët do të njoftohen në përfundim të procesit të perzgjedhjes, për datën dhe vendin e zhvillimit të trajnimit.

Përparësi do të kenë ata kandidatë që nuk janë mbështetur më parë me fonde nga ky projekt, si dhe aplikantët që synojnë të krijojnë një biznes në fusha si: turizëm dhe hoteleri, gastronomi, artizanat, teknologji informacioni e komunikim.

B. DOKUMENTACIONI

Aplikimi duhet të përmbajë:

1. Formularin e aplikimit, të firmosur, që mund ta shkarkoni në linkun: [Link](#)
2. Projekt propozim për një ide biznesi;
3. Vërtetim papunësie nga zyra e punësimit, ose nga administrata tatimore ose të shkarkuar nga e-albania;
4. Dokument identifikimi (kartë identiteti/pasaportë);
5. Curriculum vitae (CV) të individit aplikues.



Funded by
the European Union





Funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020

Të interesuarit duhet të dërgojnë aplikimet e tyre në pranë zyrës së Arshivë – Protokollit, pranë AIDA-s, në adresën: Rruga “Skerdilajd Llagami”, Ndërtesa nr.1, H.6, Tiranë, ose në adresën elektronike të e-mailit info@aida.gov.al, jo më vonë se data 18 Mars 2024, ora 16.30. Aplikimet e dorëzuara, përtej datës dhe orës së përcaktuar, nuk do të merren në shqyrtim.

Për çdo pyetje/sqarim në lidhje me këtë thirrje, mund të kontaktoni në adresën elektronike të AIDA-s, info@aida.gov.al.

Tiranë, 22.02.2024



Funded by
the European Union

